



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



ANALIZA E TRENDIT 2024

MITROVICĚ 2024

ANALIZA E TRENDIT 2024

POROSITËSI I HULUMTIMIT:

OJQ AKTIV

Kralja Petra I, 183a, Mitrovica e Veriut
Qamil Hoxha 38/1, Prishtinë
Kosovska 17/3, Beograd

BOTUESI:

Miodrag Miliçević

AUTORI:

Dr. Marko Savković, këshilltar i lartë, Fondi ISAC

PËRPUNIMI STATISTIKOR I TË DHËNAVE:

Senka Kostiq

DIZAJNI:

Darija Viro

MITROVICË, DHJETOR 2024.

Ky punim u botua në kuadër të projektit Rritja e Potencialit Avokues të Organizatave të Shoqërisë Civile Serbe të Kosovës, i implementuar nga OJQ AKTIV me mbështetjen financiare të Fondi Kombëtar për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED.) Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e OJQ-ve AKTIV dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e NED.

Përmbajtja

HYRJE	7
TRENDET MË TË RËNDËSISHME	8
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE PËRSHKRIMI I MOSTRËS	9
REZULTATET E HULUMTIMIT	13
BESIMI NË VENDIMMARRËSIT	29
BESIMI NË INSTITUCIONE	37
QËNDRIMET NDAJ PJESËMARRJES AKTIVE NË PROCESET POLITIKE ..	45
LIRIA E SHPREHJES DHE QASJA NË INFORMACIONE	55
SIGURIA E QYTETARËVE	65
TENDENCAT E MIGRIMIT	69
QËNDRIMET NDAJ BASHKIMIT EVROPIAN	75
ISTANCA ETNIKE	71
PËRFUNDIM	87

HYRJE

“Analiza e Trendeve” është hulumtimi vjetor i opinionit publik që organizata joqeveritare **AKTIV** e realizon që nga viti 2016.

Fillimisht në katër komuna në veri të Kosovës, e që nga viti 2019 edhe në komunat e tjera me shumicë serbe, ka për qëllim studimin e detajuar të qëndrimeve dhe perceptimeve të komunitetit serb në Kosovë mbi çështjet më të rëndësishme shoqërore dhe politike.

Bazuar në hulumtimin e kryer, konstatojmë se tendencat negative vazhdojnë. Një vit pas ngjarjeve në Banjskë, frika nga një konflikt i hapur mund të jetë zvogëluar, por ndjenja e pasigurisë mbetet e përhapur. Qytetarët e nacionalitetit serb presin shumë pak gjëra pozitive në të ardhmen.

Gjetjet tregojnë qartë për një pakënaqësi të thellë dhe pesimizëm të komunitetit serb në Kosovë. Shumica e të anketuarve besojnë se situata nuk po shkon në drejtimin e duhur, me pritshmëri minimale për përmirësim të jetës në vitet e ardhshme. Paqëndrueshmëria politike dhe mungesa e besimit në institucione, parti politike dhe individë të caktuar forcojnë më tej ndjenjën e pasigurisë, e cila është e dukshme tek një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve. Aktorët ndërkombëtarë si Rusia vazhdojnë të gëzojnë besimin më të madh kur bëhet fjalë për mbrojtjen e interesave të serbëve, ndërsa idetë si ndarja territoriale mbeten jopopullore. Rritja e besimit në mediat lokale në gjuhën serbe është një nga aspektet e rralla pozitive në këtë studim.

Ashtu siç u konstatua në hyrjen e hulumtimit të vitit të kaluar, “presioni i madh që qeveria në Prishtinë ka ushtruar mbi komunitetin serb do të ketë pasoja afatgjata negative për marrëdhëniet ndëretnike dhe bashkëpunimin midis komuniteteve”. Në vend të komunikimit dhe bashkëpunimit, kemi dhe do të kemi pasiguri dhe mosbesim.

Shumica dërrmuese e të anketuarve

91.2%

besojnë se situata në Kosovë nuk po shkon në drejtimin e duhur. Vetëm 1 në 10 të anketuar beson se jeta për serbët në Kosovë do të përmirësohet në tre vitet e ardhshme, ndërsa

57.9%

e të anketuarve e konsiderojnë paqëndrueshmërinë politike si problemin kryesor në Kosovë.

Në këtë kapitull në pika të shkurtra janë paraqitur trendet më domethënëse për vitin 2024, ndërsa në tekstin në vazhdim janë paraqitur në detaje të gjitha të dhënat e disponueshme. Kur bëhet fjalë për trendet kyçe:

72%

e të anketuarve thonë se në Kosovë **nuk ekzistojnë** parti politike apo politikanë të cilëve u besojnë.

Sipas vlerësimit të banorëve të veriut, niveli më i ulët i besimit është ndaj Qeverisë dhe deputetëve serbë në Kuvendin e Kosovës, të cilët janë vlerësuar me notën “një”

Mesatarisht, **një në pesë** të anketuar të nacionalitetit serb mendon se **siguria e tij/saj ka qenë e rrezikuar** gjatë vitit të kaluar.

25.8%

e të anketuarve besojnë se Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe do të formohet.

Vetëm

9%

e të anketuarve mbështesin idenë e demarkacionit, ndërsa

18.3%

janë “të hapur për këtë ide”.

48.1%

e të anketuarve janë kundër.

44.7%

e të anketuarve besojnë se, nga akterët ndërkombëtarë, **Rusia është mbrojtësi më i mirë i interesave të serbëve në Kosovë.**

Një e treta e të anketuarve do të “largohej nëse do t’i jepej mundësia”

Vërehet **një rritje e konsiderueshme** e besimit në mediat në gjuhën serbe nga Kosova.

STRUKTURA E MOSTRËS SIPAS GJINISË



Metodologjia e hulumtimit dhe përshkrimi i mostrës

MËNYRA E HULUMTIMIT:

Hulumtimi është realizuar përmes metodës së terrenit. Mjeti kryesor ishte metoda e anketimit.

INSTRUMENTI:

Pyetësi përbëhej nga 43 pyetje.


PERIUDHA E HULUMTIMIT:

Kohëzgjatja e hulumtimit ishte nga qershori deri në dhjetorin të vitit 2024.

PERIUDHA E HULUMTIMIT:


Analiza bazohej në një mostër prej 503 të anketuarve.

STRUKTURA E MOSTRËS SIPAS VENDBANIMIT TË TË ANKETUARVE




STRUKTURA E MOSTRËS SIPAS MOSHËS


Bazuar në shpërndarjen e të dhënave, vërehet se në mostër ka më shumë të anketuar të rinj në krahasim me kategorinë e të anketuarve më të moshuar.



STRUKTURA E MOSTRËS SIPAS ARSIMIT



STRUKTURA E MOSTRËS SIPAS STATUSIT TË PUNËSIMIT TË ANKETUARVE



Përqindja më e madhe e grupit të anketuarve është e papunë, pastaj një përqindje e ngjashme është e punësuar në institucione publike në sistemin serb, ndërsa vetëm 5.2% e të anketuarve kanë biznesin e tyre.

Fokus grupet dhe devijimet në gjetjet e hulumtimit

Gjatë zbatimit të hulumtimit, është identifikuar nevoja për organizimin e fokus grupeve shtesë, me qëllim të thellimit të procesit hulumtues dhe sqarimit të devijimeve të vërejtura gjatë analizës së të dhënave ekzistuese sasiore. Në veçanti, rezultatet e anketave të kryera në territorin e komunës së Leposaviqit kanë devijuar dukshëm nga rezultatet e komunave tjera, veçanërisht në sferën e perceptimit të sigurisë.

Për të kuptuar më thellë këto devijime, janë zbatuar tre fokus grupe, të cilat përfshinin gjithsej 30 pjesëmarrës të moshave të ndryshme, profileve sociale dhe profesionale. Këto fokus grupe kanë mundur një pasqyrë shtesë mbi kontekstin lokal shoqëror dhe të sigurisë, i cili nuk ishte plotësisht i përfshirë nga instrumentet sasiore.

Analiza e të dhënave kualitative tregon se dallimi prej 15% në perceptimin e sigurisë, i evidentuar në hulumtimin sasior, nuk ka mundur të konfirmohet gjatë diskutimeve në kuadër të fokus grupeve. Një nga shpjegimet e mundshme për këtë dallim është fakti se hulumtimi është zhvilluar gjatë muajve të verës, kur shpeshësia e incidenteve të sigurisë është tradicionalisht më e ulët, gjë që mund të ndikojë në ndjenjën subjektive të sigurisë tek qytetarët. Megjithatë, ky përfundim kërkon verifikim të mëtejshëm, duke pasur parasysh që pikërisht gjatë asaj vere është regjistruar një rritje e incidenteve, veçanërisht në marrëdhëniet ndërmjet policisë dhe komunitetit serb.

Përveç faktorit sezonal, një hipotezë shtesë e nxjerrë nga fokus grupe tregon për mundësinë që disa nga të anketuarit në hulumtimin kuantitativ të kenë lidhje familjare apo personale me punonjës të organeve komunale, legjitimiteti i të cilëve është vënë në pikëpyetje për shkak të bojkotit të zgjedhjeve lokale nga ana e komunitetit shumicë serb. Kjo lidhje mund të ketë ndikuar në perceptimin e shprehur të sigurisë, veçanërisht në kontekstin e besimit institucional dhe të shprehjes publike të qëndrimeve në një ambient politikisht të ndjeshëm. Për shkak të madhësisë së kufizuar të mostrës, asnjëra nga këto hipoteza të cekura nuk mund të konfirmohet me një shkallë të lartë të besueshmërisë, por në tërësi tregojnë për nevojën për kujdes të shtuar gjatë interpretimit të rezultateve.

Devijimet në të dhëna, sipas analizës së fokus grupeve, mund të jenë rezultat i një kombinimi të faktorëve të mëposhtëm:

- ▶ periudha sezonale e zbatimit të hulumtimit (muajt e verës),
- ▶ profili i të anketuarve potencialisht të lidhur me pushtetin lokal dhe/ose institucionet legjitimiteti i të cilave është kontestuar.

Gjetjet kryesore nga të tri fokus grupet, së bashku me audio regjistrimet dhe transkriptet përkatëse të diskutimeve, konfirmojnë se rezultatet e hulumtimit sasior kërkojnë interpretim shtesë dhe nuk mund të trajtohen si plotësisht përfaqësuese. Këto gjetje janë analizuar hollësisht dhe janë paraqitur në një shtojcë të veçantë të këtij dokumenti, së bashku me rekomandimet për përmirësimin e metodologjisë në ciklet e ardhshme të hulumtimit.



The background features a large, light-colored gear centered on the page. Surrounding the gear are several bar charts with various numerical values. One chart on the left has the word 'ANALYSIS' written vertically. Other charts show values such as 335, 325, 175, 350, 395, 370, and 290. The word 'DDD' is repeated multiple times in a grid-like pattern across the background.

REZULTATET E HULUMTIMIT

Sa i përket situatës politike, ekonomike, të sigurisë dhe financiare në Kosovë, të anketuarit e nacionalitetit serb kanë dhënë vlerësime në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 më i larti.

Sa e rëndë është situata në të vërtetë, na tregon treguesi i parë – vlerësimi i situatës. Në shkallën nga 1 deri në 5, situata e sigurisë është vlerësuar me një nivel jashtëzakonisht shqetësues prej 1.76; situata politike me një vlerësim pothuajse identik prej 1.79; situata ekonomike me një vlerësim pak më të lartë prej 1.92; dhe, më në fund, situata materiale me 2.63.

	Vlerësim mesatar
Situata politike	1.79
Situata ekonomike	1.92
Situata e sigurisë	1.76
Situata materiale	2.63

Edhe kur njerëzit kanë kushte themelore për jetesë, cilësia e asaj jete mbetet thellësisht e dëmtuar. Vlerësimet me “njësh” për parametrat kyç, si stabiliteti politik, situata ekonomike dhe ndjenja e sigurisë, tregojnë se jeta është e karakterizuar nga pasiguria, frika dhe pakënaqësia e thellë.

Veçanërisht shqetësues është fakti se vetëm një nga njëqind të anketuarit që jetojnë në veri e ka vlerësuar situatën e tij materiale si të mirë. Për më tepër, vlerësimet mesatare janë përkeqësuar krahasuar me vitin 2020. Atëherë, këta parametra ishin vlerësuar mesatarisht të paktën me “dysh”. Rënia më e madhe u regjistrua vitin e kaluar pas ngjarjeve në Banjskë.


Prandaj, nuk është për t'u habitur që bindja se “gjërat nuk po shkojnë në drejtimin e duhur” është e pranishme te 90% e të anketuarve, pa dallim nëse jetojnë në veri apo në jug të lbrit. E njëjta rënie nga viti 2020 është e dukshme si në vlerësimet mesatare ashtu edhe në numrin e atyre që besojnë se situata po përmirësohet.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten vlerësimet mesatare për të katër kategoritë gjatë pesë viteve të fundit.

	2024	2023	2022	2021	2020
Situata politike	1.79	1.51	2.05	2.01	2.06
Situata ekonomike	1.92	1.85	2.07	2.20	2.08
Situata e sigurisë	1.76	1.46	2.04	1.93	2.17
Situata materiale	2.63	2.70	2.60	2.74	2.84

Janë regjistruar vlerësime mesatare dukshëm më të ulëta në nëngrupet e të anketuarve nga veriu i Kosovës.


- Veriu i Kosovës
- Komunitat me shumicë serbe në jug të Ibrit



Në grafikët vijues paraqitet frekuenca e vlerësimeve individualisht për secilin domen në raport me vendbanimin e të anketuarve.


SITUATA POLITIKE

Madje 90% e të anketuarve që jetojnë në veri të Kosovës e kanë vlerësuar situatën politike si shumë të keqe ose të keqe. Qytetarët në jug e vlerësojnë situatën politike pak më mirë, por megjithatë, 69% e tyre e perceptojnë atë si të keqe ose shumë të keqe. Vazhdon të mbetet një përqindje jashtëzakonisht e lartë e të anketuarve që e shohin situatën politike si të keqe, ndërsa numri i atyre që e konsiderojnë atë të mirë është ulur edhe më tej.




SITUATA EKONOMIKE

Trendi i rënies së kënaqësisë me situatën ekonomike ka vazhduar. Dallimi (vetëm) qëndron në faktin se në veri ka më shumë persona që e vlerësojnë atë si shumë të keqe, ndërsa në jug ka më shumë ata që përdorin përshkrimin “e keqe”. Megjithatë, në jug ka dukshëm më shumë qytetarë që situatën ekonomike e vlerësojnë si “neutrale” (25,4%) dhe madje edhe si “të mirë” (10,2%).




SITUATA E SIGURISË

Rezultatet e hulumtimit të opinionit publik tregojnë se situata e sigurisë në Kosovë vazhdon të jetë shumë e keqe. Në veri të Kosovës, madje 66,8% e të anketuarve e konsiderojnë sigurinë si “shumë të keqe”, ndërsa vetëm 2,8% e vlerësojnë atë si “të mirë”. Në jug të Kosovës, situata nuk është shumë ndryshe, ku vetëm 4,7% e qytetarëve e shohin sigurinë si “të mirë”. Këto të dhëna tregojnë qartë se një përqindje e lartë e popullsisë ende e percepton situatën e sigurisë si një problem serioz.




STATUSI MATERIAL




Ashtu si situata ekonomike, edhe situata materiale perceptohet si disi më e mirë nga të anketuarit që jetojnë në jug të Ibrit.

A PO SHKOJNË GJËRAT NË DREJTIMIN E DUHUR NË KOSOVË?

Shumica dërrmuese e të anketuarve – 90% e tyre – janë përgjigjur me “aspak” ose “kryesisht jo në këtë pyetje.



Nëse i analizojmë përgjigjet më tej, sipas vendbanimit të të intervistuarve, marrim raportin e mëposhtëm të zonave veriore dhe jugore të Ibrit:



Vlerësimi kryesor është, pra, jashtëzakonisht negativ, me një diferencë të vogël të vërejtur në jug, ku gjithashtu ka 10,5% prej atyre që besojnë se gjërat kryesisht shkojnë në drejtim të mirë.

Ky vlerësim ka përqësuar vazhdimisht që nga 2020. Pjesa e “pesimistëve” ka kulminuar në vitin 2023, për t’u përmirësuar pak situata këtë vit.



Vetë çdo 12-të i intervistuar ndan një qëndrim optimist për të ardhmen e Kosovës




NË MENDIMIN TUAJ, JETA PËR SERBËT NË KOSOVË PAS TRE VITE DO TË JETË:

Vetëm një nga 10 të anketuarve, në mesatare, beson se në tre vitet e ardhshme jeta për serbët në Kosovë do të jetë “më e mirë”. Ndërkohë, qytetarët serbë që jetojnë në jug të Ibrit janë edhe më pak optimistë; atje vetëm 8% e tyre besojnë në një të ardhme më të mirë, krahasuar me 12% në veri.

Këtu është interesante se në veri kemi si më shumë qytetarë që besojnë se do të jetë “më keq”, ashtu edhe ata që shprehin se do të jetë “më mirë”, gjë që ne e interpretojmë si një tregues i lodhjes dhe dezorientimit të komunitetit.



Numri i atyre që presin që situata të përkeqësohet edhe më shumë në vitet në vijim po rritet çdo vit.




Kush apo çfarë kontribuoi më shumë në këtë gjendje?


Një përshkrim të mirë na ka ofruar një bashkëbisedues: “Veprimet e autoriteteve në Prishtinë në 3 vitet e fundit kanë kontribuar që qytetarët ta shohin situatën e sigurisë si shumë të keqe”. Metodat represive të policisë dhe masat populiste të pushtetit në Prishtinë në dëm të komunitetit serb kanë ndikuar në sigurinë e dobët, sidomos në veri, prandaj një numër i qytetarëve janë larguar përgjithmonë nga Kosova. Kur shikojmë katër vitet e fundit, është e qartë se trendi i përkeqësimit të sigurisë është rezultat i drejtpërdrejtë i situatës politike, e cila vazhdon të krijojë vija të mëdha ndarëse ndërmjet komuniteteve, veçanërisht ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve, ku sot, ndryshe nga më parë, shumë të rinj e shohin qeverinë dhe policinë e Kosovës si armiq të hapur.”

CILI ËSHTË, SIPAS JUSH, PROBLEMI MË I MADH NË KOSOVË?

Qytetarët i njohin mirë arsyet e situatës së përshkruar dhe nuk mund të thuhet se mbizotëron vetëm një. Sipas perceptimit të të anketuarve, arsyet për shqetësimin më të madh janë paqëndrueshmëria politike (57.9%) dhe situata ekonomike/papunësia (57.1%), duke i bërë ato sfidat kryesore. Gjithashtu u theksuan probleme të tilla si migrimi dhe largimi i të rinjve (54.9%) dhe siguria (51.1%), duke treguar pasiguri sociale dhe personale. Një përqindje relativisht më e vogël, por ende në masë të madhe e të anketuarve përmendin qëndrimin e autoriteteve të Kosovës ndaj komuniteteve joshumicë (46.1%), të ndjekur nga krimi dhe korrupsioni (42.9%) si probleme kryesore.



Dallimet në qëndrimet mes qytetarëve që jetojnë në veri dhe në jug të lumit Ibër nuk janë të mëdha.




Në mënyrë të veçantë vërehet përkeqësimi në katër vitet e fundit në pjesën që ka të bëjë me situatën ekonomike. Tashmë është dyfishuar numri i atyre që e shohin si arsye për largim (të mundshëm)..


	2024	2023	2022	2021
Paqëndrueshmëria politike	57.9%	69.2%	39.2%	52.6%
Situata ekonomike/papunësia	57.1%	58.4%	65.4%	25.2%
Siguria	51.1%	64.6%	38.8%	47.4%
Krimi dhe korrupsioni	42.9%	46.6%	40.6%	43.7%
Migrimi, largimi i të rinjve	54.9%	52.2%	53.5%	51.1%

A KA NDRYSHUAR GJENDJA EKONOMIKE NË KOSOVË GJATË VITIT TË KALUAR?

Logjikisht, situata ekonomike u përkeqësua edhe gjatë vitit të kaluar. Edhe nëse qytetarët nuk e shohin qartë përkeqësimin, ata as nuk mendojnë se situata është përmirësuar, por vlerësojnë se ajo ka mbetur e pandryshuar. Duke pasur parasysh bllokadën e importit, heqjen e dinarit, si dhe një sërë masash të tjera që kanë vështirësuar kushtet e jetesës për komunitetin serb, nuk habit fakti që shumica (56,5%) e të anketuarve e konsiderojnë kështu.



Ky vlerësim është disi më i theksuar në veri, ashtu si edhe qëndrimi se “asgjë nuk ka ndryshuar” (38.4%)




	Po, është përmirësuar	Po, është përkeqësuar	Asgjë nuk ka ndryshuar	Nuk është përgjigjur
2024	5.2%	56.4%	38.4%	0%
2023	2.2%	63.8%	33.4%	0.6%


SI KA NDIKUAR TEK JU VENDIMI I BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS PËR HEQJEN E DINARIT?

Përkeqësimi i situatës së përgjithshme të komunitetit serb në Kosovë - jo vetëm në kuptimin ekonomik, por edhe në atë shoqëror – është ndikuar ndjeshëm nga vendimi i Bankës Qendrore të Kosovës për të ndaluar përdorimin e dinarit si mjet pagese, si në veri, ashtu edhe në jug të Kosovës. Edhe pse e natyrës formale, kjo masë ka prodhuar pasoja të thella dhe konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve, veçanërisht të kategorive më të cënuara – pensionistëve, përfituesve të ndihmës sociale dhe personave me lëvizshmëri të kufizuar. Përveç mbylljes së NLB Komercijalna banka, e cila ishte një nga institucionet e rralla financiare me licencë për të operuar me dinarë, janë mbyllur gjithashtu degë të Postës së Serbisë dhe Poštanska šteditonica në të gjithë territorin e Kosovës. Këto ndryshime e kanë vështirësuar edhe më tej qasjen në shërbimet themelore financiare për të gjitha shtresat e popullsisë, duke detyruar shumë qytetarë të udhëtojnë me disa qindra kilometra, për të realizuar qasjen në pagat, pensionet, shtesat për fëmijë dhe përfitimet tjera sociale.

Anketat e opinionit publik kanë treguar se madje 10% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë të ardhura në dinarë, por pavarësisht kësaj, kanë ndier pasojat e këtij vendimi përmes destabilizimit të mëtejshëm të situatës ekonomike lokale. Një nga bashkëbiseduesit e ka vlerësuar se “përfituese është Prishtina zyrtare sepse faktikisht ka hequr valutën serbe si mjet të pageses”, duke shtuar se “në këtë ka ndihmuar edhe Beogradi zyrtar, i cili nuk ka gjetur mekanizma për të penguar mbylljen e NLB Komercijalna banka në Kosovë”. Përveç aspektit financiar, një goditje shtesë përbën ndalimi apo vështirësimi i dukshëm i importit të mallrave nga Republika e Serbisë, gjë që rrezikon më tej mbijetesën ekonomike të ndërmarrësve serbe në Kosovë – si në veri, ashtu edhe në jug. Veçanërisht të goditur janë subjektet afariste në sektorët e tregtisë dhe shërbimeve, të cilat përballen me ulje të qarkullimit, vështirësi në furnizim dhe rritje të kostove operative, që në planin afatgjatë vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë e veprimtarisë së tyre dhe ekzistencën e të punësuarve.




Dallimet në përgjigje midis atyre që jetojnë në veri dhe në jug të lumit Ibër janë të pa-përfillshme.






**BESIMI NË
VENDIMMARRËSIT**

SA SHPESH I NDIQNI ZHVILLIMET POLITIKE?



Analiza e të dhënave të fituara tregon se qytetarët e komunitetit serb në Kosovë ndjekin në masë të madhe zhvillimet politike. Sipas rezultateve të hulumtimit, 21.7% e të anketuarve kanë deklaruar se i ndjekin ngjarjet politike çdo ditë, ndërsa 37% të tjerë thanë se i ndjekin shpesh ato. Këto të dhëna tregojnë se gjithsej 58.7% e të anketuarve janë të përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në ndjekjen e zhvillimeve politike, gjë që përfaqëson një nivel relativisht të lartë të informimit dhe interesimit për ngjarjet politike.


Gjatë monitorimit të trendeve të këtij viti, vërehet se dallimi midis komunave me shumicë serbe në veri dhe jug të lumit Ibër është relativisht i vogël. Megjithatë, është evidentuar se përqindja pak më e lartë e qytetarëve që ndjekin rrallë situatën politike vjen nga komunat në jug të Ibrit. Ky dallim mund të shpjegohet pjesërisht me shkallën e ndryshme të ekspozimit ndaj presioneve të sigurisë, presioneve administrative dhe institucionale, si dhe dallimeve në qasjen ndaj përmbajtjeve mediale në gjuhën serbe.



Trendet tregojnë se numri i qytetarëve që ndjekin situatën politike shpesh ose çdo ditë po rritet nga viti në vit. Një zhvillim i tillë nuk është befasues, duke marrë parasysh gjendjen e vazhdueshme të jostabilitetit politik dhe institucional që ndikon ndjeshëm në jetën e përditshme të komunitetit serb në Kosovë. Interesi i shtuar për proceset politike mund të jetë gjithashtu pasojë e ndjenjës së pasigurisë dhe nevojës së qytetarëve për të qenë të informuar rreth ndryshimeve të mundshme që ndikojnë drejtpërdrejt në ekzistencën e tyre – si ndalimi i përdorimit të dinarit, mbyllja e institucioneve të Republikës së Serbisë, situata e sigurisë, si dhe një sërë nismash politike vendore dhe ndërkombëtare që lidhen me statusin dhe të drejtat e serbëve në Kosovë.

	2024	2023	2022	2021	2020
Nuk e përcjelli fare	11.3%	7.8%	10.1%	15%	10%
Rrallë	30%	32.6%	40.9%	44.1%	42.6%
Shpesh	37%	34.6%	36.4%	30.9%	31.7%
Çdo ditë	21.7%	25%	12.6%	10%	15.7%


A KA POLITIKANË/E NË KOSOVË TË CILËVE U BESONI?



Rezultatet e hulumtimit tregojnë për një hendek të theksuar dhe gjithnjë më të thellë ndërmjet aktorëve politikë dhe pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë. Bazuar në të dhënat e nxjerra, mund të konkludohet se aktualisht nuk ekziston asnjë parti politike apo individ nga jeta politike që gëzon një besim të gjerë dhe stabil brenda këtij komuniteti. Mungesa e një lideri qartë të profilizuar tek i cili qytetarët do të kishin besim tregon për një problem serioz të përfaqësimit politik dhe për ndjenjën e qytetarëve se nevojat dhe interesat e tyre po neglizhohen në mënyrë sistematike. Kjo dukuri nuk është e karakterit të përkohshëm, por tregon për një vazhdim të një trendi shumëvjeçar të mosbesimit ndaj liderëve politikë, i cili vetëm që është intensifikuar me kalimin e viteve. Hulumtimet e pesë viteve të fundit në mënyrë konsistente kanë regjistruar një skepticizëm në rritje, ndërkohë që pritjet dikur të larta ndaj institucioneve dhe përfaqësuesve politikë – si atyre lokalë, ashtu edhe atyre nga Beogradi – në masë të madhe janë dëshmuar si të zhgënjyera.

Si pasojë e kësaj, tek një pjesë e konsiderueshme e popullsisë është zhvilluar një ndjenjë frustrimi dhe dëshpërimi politik, që komplikon më tej procesin e demokratizimit, pjesëmarrjes dhe fuqizimit të komuniteteve lokale. Në këtë kontekst, viti 2023 përfaqëson kulmin e këtij mosbesimi, kur është regjistruar niveli më i ulët i besimit ndaj aktorëve politikë që nga fillimi i monitorimit të këtyre treguesve. Veçanërisht është e rëndësishme të theksohet se mosbesimi është më i theksuar në komunat në veri të Kosovës, ku dinamika politike lidhet më drejtpërdrejt me sfidat e sigurisë, ndryshimet institucionale dhe presionet, si dhe me ngjarjet që kanë lënë gjurmë të forta në kujtesën kolektive të popullsisë lokale (p.sh. tërheqja nga institucionet, incidentet me KFOR-in dhe forcat e policisë së Kosovës, shuarja e institucioneve të Republikës së Serbisë). Kjo rënie e besimit në udhëheqjen politike mund të interpretohet edhe si thirrje për një reredefinim të marrëdhënieve ndërmjet strukturave politike dhe qytetarëve – për nevojën të transparencës, përgjegjshmërisë më të madhe dhe përfaqësimit autentik të interesave të komunitetit serb në Kosovë, të cilat sipas mendimit të vetë qytetarëve, në vitet e fundit kanë mbetur të panjohura dhe të pambrojtura.

■ Jo
 ■ Po
 ■ Nuk e ndjekim politikën mjaftueshëm për të dhënë përgjigje



	2024	2023	2022	2021	2020
Po	8.9%	6%	8.4%	10.9%	14.3%
Jo	72%	83.5%	67.1%	60.2%	58.7%
Nuk e përcjelli politikën mjaftueshëm për t'u përgjigjur	19.1%	9.9%	24.5%	28.9%	27%
Nuk është deklaruar	0%	0.6%	0%	0%	0%

CILIT POLITIKAN APO CILËS PARTI POLITIKE SERBE NË KOSOVË I BESONI?

Duke lexuar rezultatet, fillimisht mund të konkludohet se nuk ka asnjë politikan konkret të cilit komuniteti serb i beson. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se qytetarët „nuk i besojnë askujt“, por thjesht nuk përgjigjen se kujt i besojnë, dhe këtë e tregojnë edhe rezultatet. Listës Serbe i besojnë vetëm 2,8% e të anketuarve, ndërsa Demokracisë Serbe 1,4%. Me emër dhe mbiemër, Sasha Milosheviq-it i besojnë 1,2%, ndërsa Aleksandar Arsenijeviq-it 0,8%. Besimi ndaj politikanëve dhe opsioneve të tjera politike është i papërfillshëm (më pak se 0,5%).

Nuk janë përgjigjur	86.9%
Asnjërit	4.0 %
Lista Serbe	2.8%
Demokracia Serbe	1.4%
Sasha Milosheviq	1.2%
Aleksandar Arsenijeviq	0.8%
Liria, Drejtësia dhe Mbijetesa	0.4%
Partia e Serbëve të Kosovës	0.4%
NPS	0.4%
Aleksandar Vuçiq	0.4%
Stefan Velkoviç	0.3%
SNS	0.2%
Rashiq	0.2%
„I përcjelli zhvillimet politike, por nuk i besoj askujt“	0.2%
Branisllav Nikoliç	0.2%
Branimir Stojanoviç	0.2%

CILIT POLITIKAN APO CILËS PARTI POLITIKE SHQIPTARE NË KOSOVË I BESONI?

Pamja është edhe më pesimiste kur flitet për besimin në politikanët nga radhët e komunitetit shumicë, shqiptar. 94% e të anketuarve nuk janë përgjigjur fare në këtë pyetje; vetëm 0,4% e tyre i besojnë kryeministrit aktual, Albin Kurti, ndërsa 5,4% kanë deklaruar në mënyrë eksplicite se nuk i besojnë „asnjërit“. Krahasuar me vitin 2023, kur disa të anketuar e kishin përmendur edhe emrin e Veton Surroit, këtë vit, përveç kryeministrit Kurti, nuk u përmend asnjë emër tjetër.

Nuk janë përgjigjur	94.2%
A. Kurti	0.4%
Asnjërit	5.4%



**BESIMI NË
INSTITUCIONE**

NË SHKALLË NGA 1 DERI NË 5, VLERËSONI SA JENI TË KËNAQUR ME PUNËN E INSTITUCIONEVE TË MËPOSHTME:

	Vlerësim mesatar
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	2.33
Komunat në sistemin e Kosovës në mjediset me shumicë serbe	2.13
Zyra për Kosovën dhe Metohinë	2.37
Qeveria e Serbisë	2.49
Qeveria e Kosovës	1.68
Deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës	1.72
Ministrat serbë në Qeverinë e Kosovës	1.71
Policia e Kosovës	2.22
UNMIK-u	2.35
Zyra e BE-së në Kosovë	2.20
EULEX-i	2.21
KFOR-i	2.55
OSBE-ja	2.31

Kur flasim për besimin në institucione, vazhdojnë trendet e evidentuara viteve të kaluara. Serbët kanë besim më të madh, sipas renditjes, në KFOR-in (nota mesatare 2,55), Qeverinë e Serbisë (2,49), Zyrën për Kosovë dhe Metohi (2,37), UNMIK-un (2,35), organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale (2,33) dhe OSBE-në (2,31). Në anën tjetër të shkallës janë Qeveria e Kosovës (1,68), ministrat serbë në Qeverinë e Kosovës (1,71), deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës (1,72) dhe komunat në sistemin e Kosovës në mjediset me shumicë serbe (2,13). Diku në mes gjenden Zyra e BE-së në Kosovë (2,20), EULEX-i (2,21) dhe Policia e Kosovës (2,22). Me këto vlerësime, vështirë se dikush mund të jetë i kënaqur.


Besimi është pak më i lartë – edhe pse larg nga ai ideal – në mjediset me shumicë serbe në jug të Ibrit. Atje, në mesatare, vlerësimet janë më të larta për të gjithë aktorët, me përjashtim të Qeverisë së Kosovës (1,44 në veri, 1,94 në jug), Policisë së Kosovës (1,93 në veri, 2,5 në jug), dhe interesant, KFOR-it (që përsëri është vlerësuar më mirë në total).

	Veriu i Kosovës	Komunat me shumicë serbe në jug të Ibrit
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	1.81	2.82
Komunat në sistemin e Kosovës në mjediset me shumicë serbe	1.57	2.66
Zyra për Kosovën dhe Metohinë	1.85	2.88
Qeveria e Serbisë	1.92	3.04
Qeveria e Kosovës	1.40	1.94
Deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës	1.30	2.12
Ministrat serbë në Qeverinë e Kosovës	1.37	2.04
Policia e Kosovës	1.93	2.50
UNMIK-u	2.03	2.66
Zyra e BE-së në Kosovë	1.85	2.54
EULEX-i	1.98	2.44
KFOR-i	2.37	2.72
OSBE-ja	1.87	2.73

Ndoshta në mënyrë të pritshme, përveç Qeverisë së Serbisë, Zyrës për Kosovë dhe Metohi dhe organeve të përkohshme të vetëqeverisjes lokale, nuk ekziston asnjë institucion tjetër puna e të cilit në pesë vitet e kaluara do të kënaqte qytetarët në një masë që të justifikonte qoftë edhe vlerësimin „mirë“ (nga 2,5 e lart). Aty afër është KFOR-i, besimi ndaj të cilit është rritur krahasuar me vitin 2020 (nga 2,23 në 2,55). Gjithashtu, duket se tek qytetarët serbë është e pranishme dëshira që institucioneve të bashkësisë ndërkombëtare (UNMIK-u, BE-ja, EULEX-i) t’u besohet më shumë, krahasuar me vitin e vështirë 2023.


	2024	2023	2022	2021	2020
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	2.33	2.17	2.55	2.59	2.56
Komunat në sistemin e Kosovës në mjediset me shumicë serbe	2.13	2.15	2.50	2.60	2.45
Zyra për Kosovën dhe Metohinë	2.37	2.46	2.74	2.82	2.54
Qeveria e Serbisë	2.49	2.53	3.07	3.22	2.89
Qeveria e Kosovës	1.68	1.61	1.77	1.73	1.95
Deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës	1.72	1.80	2.14	2.21	2.12
Ministrat serbë në Qeverinë e Kosovës	1.71	1.74	2.08	2.25	2.12
Policia e Kosovës	2.22	1.79	/	/	/
UNMIK-u	2.35	2.09	2.08	1.95	2.19
Zyra e BE-së në Kosovë	2.20	1.95	1.99	1.95	2.09
EULEX-i	2.21	1.99	1.96	1.79	1.96
KFOR-i	2.55	2.18	2.31	2.09	2.23

CILI PREJ FAKTORËVE KRYESORË NDËRKOMBËTARË ËSHTË, SIPAS MENDIMIT TUAJ, MBROJTËSI MË I MIRË I INTERESAVE TË SERBËVE NË KOSOVË?




Qytetarët e përkatësisë kombëtare serbe në Kosovë vazhdojnë të kenë më së shumti besim në Rusinë (44.7%), megjithëse kjo përqindje është në rënie të konsiderueshme dhe të vazhdueshme krahasuar me vitin 2020, kur arrinte në 69.6%. Kjo rënie tregon për dobësimin e mbështetjes kryesisht emocionale dhe tradicionale në Rusinë, në favor të një vlerësimi më racional të kapaciteteve të saj reale për të ndikuar në situatën në Kosovë. Ndërkohë, besimi në BE po shënon një rritje graduale, por inkurajuese – aktualisht arrin në 21.9%, ndërsa në jug të Ibrit shkon deri në 28.5%. Ky trend lidhet me rritjen e dukshmërisë së BE-së përmes projekteve konkrete dhe mbështetjes ndaj komuniteteve lokale.

Megjithatë, veriu i Kosovës vazhdon të shfaqë mosbesim të thellë – vetëm 15% e të anketuarve atje e shohin BE-në si mbrojtëse të interesave të serbëve. Besimi në Kinë mbetet i qëndrueshëm në një nivel më të ulët (14.1%), pa luhatje të dukshme. Ndryshimet në perceptimin ndaj akterëve ndërkombëtarë tregojnë për fillimin e një qasjeje më racionale nga ana e qytetarëve, duke vlerësuar rezultatet konkrete, dhe jo vetëm simbolikën historike apo politike. Rënia e besimit ndaj Ruisë tregon se besnikëria emocionale nuk është më e mjaftueshme pa mbështetje konkrete. BE-ja ka potencialin të forcojë më tej besimin, veçanërisht nëse i përgjigjet nevojave specifike të komuniteteve në veri të Ibrit. Këto rezultate hapin mundësi për rishikimin e qasjeve të partnerëve ndërkombëtarë me qëllim të forcimit të stabilitetit dhe besimit në terren.




	2024	2023	2022	2021	2020
Bashkimi Evropian	21.9%	15.7%	9.8%	8.9%	7.7%
Rusia	44.7%	56.9%	64.3%	65.6%	69.6%
SHBA-ja	2.4%	2.8%	1.7%	3%	1.7%
Kina	14.1%	11.8%	13%	17%	13.3%



A POSEDONI DOKUMENTE PERSONALE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E KOSOVËS (LETËRNJOFTIM, PASAPORTË, PATENTË SHOFERI, CERTIFIKATË TË LINDJES DHE SHTETËSI (EKSTRAKT))...?




Të dhënat tregojnë një trend të qartë të rritjes së numrit të qytetarëve që posedojnë dokumente të Kosovës. Në krahasim me vitin e kaluar, numri i atyre që nuk posedojnë dokumente të Kosovës ka rënë nga 13% në 6.4%. Qytetarët, shpesh pa pasur zgjidhje për shkak të mospërnjohjes së dokumenteve të lëshuara nga Republika e Serbisë, kanë pranuar të pajisen me dokumente të Kosovës. Shumë prej tyre janë përballur me probleme siç janë pritjet mbi dy muaj për marrjen e dokumenteve, mospërfillja e të drejtave gjuhësore dhe mungesa e mirëkuptimit nga ana e zyrtarëve në zyrat e regjistrimit civil. Vështirësi të veçanta janë shfaqur gjatë marrjes së ekstrakteve, veçanërisht për personat që nuk janë lindur në Kosovë ose për prindërit që kanë kërkuar dokumente personale për fëmijët e tyre. Përvoja të pakëndshme, si mungesa e mirësjelljes nga ana e zyrtarëve dhe pengesat administrative, e kanë bërë këtë proces edhe më të vështirë. Edhe pse mënyra e pranimit të dokumenteve nuk ka qenë e lehtë, vetë fakti që qytetarët gjithnjë e më shpesh vendosin të ndërmarrin këtë hap, mund të shihet si një sinjal pozitiv. Ky trend është i pranishëm edhe në veri të Kosovës, ku 10% e të anketuarve ende nuk posedojnë dokumente të Kosovës. Pavarësisht rezistencës ekzistuese, gjithnjë e më shumë qytetarë po vendosin të pajisen me letërnjoftime për shkak të nevojave të përditshme dhe qasjes në të drejtat themelore. Këto rezultate tregojnë për një ndryshim të ngadalshëm, por të rëndësishëm, i cili mund të kontribuojë në forcimin e dialogut dhe stabilitetit të ardhshëm.




A KENI HASUR NDONJË PROBLEM NË MARRJEN E NDONJË PREJ DOKUMENTEVE?






**QËNDRIMET NDAJ
PJESËMARRJES
AKTIVE NË
PROCESET
POLITIKE**

CILI ËSHTË QËNDRIMI JUAJ NDAJ VAZHDIMIT TË NEGOCIATAVE/BISEDIMEVE MES BEOGRADIT DHE PRISHTINËS NËN NDËRMJETËSIMIN E BE-SË (DIALOGU I BRUKSELIT)?




Gjatë vitit 2024 është vërejtur një rritje e konsiderueshme e mbështetjes së qytetarëve për procesin negociues në Bruksel ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Ndryshe nga viti 2023, gjithnjë e më shumë qytetarë e shohin dialogun si opsionin më realist për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky ndryshim në perceptim është rezultat i zhvillimeve politike dhe të sigurisë që kanë rritur ndjenjën e urgjencës dhe nevojën për kompromis. Sipas të dhënave, 41.7% e të anketuarve nuk kanë një qëndrim për vazhdimin e negociatave, ndërsa mbështetja dhe kundërshtimi ndaj dialogut janë të barabarta me nga 29%. Mbështetja për dialogun është veçanërisht më e madhe në veri të Kosovës, ku pasojat e vendimeve politike janë më të dukshme. Krahasuar me vitin 2020, numri i mbështetësve të dialogut është rritur për 9%, ndërsa numri i kundërshtarëve është ulur. Ngjarjet e kaluara, jo vetëm ato të vitit të kaluar, kanë forcuar më tej bindjen për rëndësinë e negociatave. Në krahasim me vitin 2023, mbështetja për procesin është rritur, ndërsa numri i kundërshtarëve është zvogëluar dukshëm. Përqindja e atyre që nuk kanë qëndrim mbetet e lartë, por stabile.




	2024	2023	2022	2021	2020
E mbështes	29%	18.2%	17.5%	22.4%	20.6%
Nuk e mbështes	29%	42.8%	40.5%	25.9%	28.7%
Nuk kam qëndrim	41.7%	39%	42%	51.7%	50.7%
Nuk është përgjigjur	0.3%	0%	0%	0%	0%

SIPAS MENDIMIT TUAJ, SI DO TË NDIKOJË VAZHDIMI I DIALOGUT NDËRMJET BEOGRADIT DHE PRISHTINËS NË KOMUNITETIN SERB NË KOSOVË?




Vendimmarrësit dhe ndërmjetësit në procesin e dialogut duhet të marrin seriozisht në konsideratë faktin që qytetarët, si në veri ashtu edhe në jug të Ibrit, kryesisht nuk presin që dialogu do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit serb në Kosovë. Ekzistojnë dallimet në perceptim midis veriut dhe jugut, por ato janë minimale, që tregon për një atmosferë të përgjithshme të mosbesimit.

Në krahasim me vitin 2023, inkurajon fakti që ka më pak qytetarë që presin përkeqësim, ndërsa ka një rritje të lehtë të numrit të atyre që janë optimistë. Këto trende tregojnë se ekziston hapësirë për rindërtimin e besimit, por që për këtë është e nevojshme që procesi i dialogut të lidhet më dukshëm me përmirësimet konkrete në jetën e përditshme të qytetarëve. Pa një komunikim më të fortë për përfitimet që dialogu mund të sjellë për komunitetet lokale, skepticizmi do të mbetet një sfidë e rëndësishme për qëndrueshmërinë e marrëveshjeve të arritura.




	2024	2023	2022	2021
Do ta përmirësojë cilësinë e jetës së komunitetit serb	19.9%	14.1%	15%	18.9%
Do ta përkeqësojë cilësinë e jetës së komunitetit serb	31.4%	35.9%	38.1%	23.7%
Gjithçka do të mbetet e njëjtë	48.5%	50%	46.9%	57.4%
Nuk është përgjigjur	0.2%	0%	0%	0%

A DO TË FORMOHET ASOCIACIONI I KOMUNAVE SERBE?



Pak më i madh është numri i të anketuarve që besojnë se Asociacioni i komunave serbe (AKS) do të formohet; 25,8% janë përgjigjur me „po“, ndërsa 27,5% janë përgjigjur „po, por jo këtë vit“. Ndërkaq, 46,7% e të anketuarve kanë vlerësuar se „nuk do të formohet“.




	2024	2023	2022	2021	2020
Po	25.8%	19%	14%	14.1%	10.5%
Po, por jo këtë vit	27.5%	33.5%	27.3%	38.5%	31.5%
Nuk do të formohet	46.7%	47.5%	58.7%	47.4%	58%

Duke bërë një krahasim me vitet e kaluara, vërehet një rritje e lehtë e besimit në formimin e AKS-së. Kështu, për shembull, në vitin 2020, vetëm 10% e të anketuarve besonin se AKS do të formohej, ndërsa 58% besonin se nuk do të ndodhte. Ky ndryshim, edhe pse i kufizuar, mund të tregojë një rritje të pjesshme të besimit në zbatimin e marrëveshjeve politike.


Motivi i mbështetjes për AKS-në reflektohet më tej në deklaratën e njërit prej të anketuarve, i cili thotë se “mediat nga Beogradi e paraqesin këtë si diçka të rëndësishme që serbët në Kosovë duhet të fitojnë”. Ky perceptim tregon për rolin e rëndësishëm të narrativës mediale në formësimin e opinionit publik dhe pritshmërive të qytetarëve lidhur me çështjen e AKS-së. Në tërësi, rezultatet tregojnë se, ndonëse pritjet për formimin përfundimtar të AKS-së janë në rritje, në të njëjtën kohë ekziston një skepticizëm i theksuar lidhur me shpejtësinë dhe vullnetin politik për ta realizuar këtë marrëveshje në një afat të shkurtër.

A E MBËSHTESNI IDENË E PËRCAKTIMIT TË KUFIJVE, PËRKATËSISHT NDARJES SË KOSOVËS?

Qytetarët e dëshirojnë më pak skenarin e „ndarjes“. 48.1% e të anketuarve janë kundër, ndërsa vetëm 9% e mbështesin plotësisht. Ata që janë „të hapur ndaj kësaj ideje“ janë 18,3%.



Është e pritshme që në veri të Ibrit të ketë më shumë njerëz që janë „pro“. Megjithatë, edhe këtu shumica prej 57.9% janë plotësisht kundër ose nuk e mbështesin idenë e ndarjes.




Megjithatë, numri i atyre që janë absolutisht kundër është ulur krahasuar me vitin 2020, nga 58.7% në 48%. Ndërkohë, qytetarët ishin dukshëm më të hapur ndaj kësaj ideje në vitin 2023.

	2024	2023	2022	2021	2020
E mbështes plotësisht	8.9%	14.8%	4.2%	4.3%	4.8%
Nuk kam informacione të mjaftueshme, por jam i/e hapur ndaj kësaj ideje	18.3%	16.7%	12.1%	20.6%	12.2%
Nuk kam informacione të mjaftueshme, por nuk e mbështes përcaktimin e kufijve	24.7%	17.8%	32.7%	21.1%	24.3%
Nuk e mbështes aspak	48.1%	50.7%	51%	54.1%	58.7%

SI DO TË NDIKONTE NJË NNDARJE EVENTUALE NË VENDIMIN TUAJ PËR TË VAZHDUAR JETËN NË KOSOVË?

Një gjë është e sigurt: ndarja do të çonte në largimin e shpejtë të qytetarëve serbë që jetojnë në jug të Ibrit. Nga këto komuna, 52% e të anketuarve janë përgjigjur se do ta linin vendbanimin aktual. Situata është pak më ndryshe në veri, edhe pse në ato katër komuna shumë të anketuar (49,8%) janë përgjigjur se „nuk do të kishte ndikim“.




Edhe këtu vërehet një rritje e caktuar, apo mund të thuhet edhe normalizim i idesë së ndarjes, megjithatë për shumicën e qytetarëve ajo është larg skenarit të dëshiruar. Në vitin 2020, numri i atyre që mendonin se ndarja „do t’ju ndihmonte të qëndronin“ ishte dyfish më i vogël.

	2024	2023	2022	2021	2020
Negativisht, do të largohesha nga vendbanimi im aktual	37.8%	42.8%	29.4%	33.1%	41.3%
Nuk do të kishte ndikim	46.3%	46.5%	62.2%	57.2%	51.1%
Pozitivisht, ndarja do të më ndihmonte të qëndroj në vendbanimin tim	14.9%	10.7%	8.4%	9.6%	7.6%
Nuk është përgjigjur	1%	0%	0%	0%	0%


Në pesë vitet e fundit, përqindja e atyre që besojnë se do të largoheshin ka qenë rreth 40%. Duke pasur parasysh proceset aktuale migratore, është e arsyeshme të supozohet se me një ndarje eventuale, komuniteti serb që jeton në jug të lumit Ibër do të pushonte së qeni faktor politik.

PËRVEÇ MBETJES SË KOSOVËS NË SISTEMIN KUSHTETUES-JURIDIK TË SERBISË, CILI PREJ SKENARËVE TË MUNDSHËM PËR MARRËVESHJEN GJITHËPËRFSHIRËSE NDËRMJET BEOGRADIT DHE PRISHTINËS DO TË ISHTE MË I PRANUESHËM PËR SERBËT E KOSOVËS?

Në fund, çfarë dëshirojnë vetë qytetarët? Me një fjali: ose Asociacionin e komunave serbe (AKS) që u është premtuar në vitin 2013, ose – asgjë („asnjë nga opsionet e ofruara“). Ndarja, përcaktimi i kufijve, shkëmbimi (veriu të Kosovës me Luginën e Preshevës)... janë shumë larg skenarit të dëshiruar, ashtu siç është larg edhe njohja eksplicite e Kosovës nga ana e Serbisë.




Mbështetja për formimin e AKS-së është më e madhe në jug të Ibrit.



„Popullariteti“ i AKS-së si opSION është rritur gradualisht gjatë pesë viteve të fundit, nga 29% deri në 40% aktualisht. Po aq e rëndësishme është edhe rënia e vazhdueshme e numrit të atyre që janë për ruajtjen e gjendjes ekzistuese („status quo“), nga 27,6% në 11,3%. Për më tepër, „qëndrimi ndaj kësaj çështjeje ndryshonte nga viti në vit, në përputhje me pozitën e serbëve. Pas heqjes së dinarit, organeve të përkohshme dhe ndërprerjes së punës së Postës së Serbisë, qytetarët e shohin AKS-në si të vetmin mekanizëm institucional mbrojtës“

	2024	2023	2022	2021	2020
Formimi i Asociacionit të komunave serbe (në përputhje me marrëveshjet e arritura më parë)	40%	40.5%	20.4%	31.3%	29%
Shkëmbimi i territoreve (veriu i Kosovës me Luginën e Preshevës)	6.6%	4.3%	4.6%	2.4%	2.4%
Njohja e pavarësisë së Kosovës nga ana e Beogradit zyrtar	6.2%	0.9%	1.3%	0.6%	2.6%
Ruajtja e gjendjes ekzistuese (status quo)	11.3%	13.4%	25.9%	21.3%	27.6%
Asnjë nga opsionet e ofruara	33.8%	29.3%	47.8%	44.4%	38.5%
Diçka tjetër	2.1%	11.6%	0%	0%	0%


Ata që deklarojnë se do të dëshironin „diçka tjetër“ japin përgjigje të ndryshme. Për ne interesante ishin përgjigjet: „më e pranueshme për serbët do të ishte që Kosova të mbetet pjesë e Serbisë, por kjo është e pamundur“; pastaj, „Pristina dhe Beogradi të investojnë në zhvillimin ekonomik gjatë dhjetë viteve të ardhshme, dhe më pas gjeneratat e reja të diskutojnë për të ardhmen“; mandej, „shpallja e okupimit të një pjese të territorit“ (që qartazi është nën ndikimin e mediave); dhe së fundi, „që bashkësia ndërkombëtare ta marrë Kosovën si protektorat“.



**LIRIA E
SHPREHJES
DHE QASJA NË
INFORMACIONE**


MBI ÇFARË E BAZONI QËNDRIMIN TUAJ PËR POLITIKËN DHE ZHVILLIMET POLITIKE?

Edhe pse mediat ende kanë ndikim të rëndësishëm në formimin e qëndrimeve të qytetarëve për situatën në Kosovë (22.5% e të anketuarve e konfirmojnë këtë drejtpërdrejt), një numër gjithnjë e më i madh qytetarësh shprehin bindjen se e formojnë vetë mendimin e tyre. Mesatarisht, numri i atyre që mendojnë se vetë e krijojnë qëndrimin e tyre është rritur për 10% krahasuar me vitin 2020, gjë që tregon për forcimin e ndjenjës së autonomisë individuale në interpretimin e ngjarjeve politike dhe shoqërore.



Një trend veçanërisht interesant është vërejtur në veri të Kosovës, ku madje 40% e të anketuarve theksojnë se nuk varen nga burimet tradicionale të informimit, por se vetë e formojnë mendimin e tyre. Kjo mund të jetë reflektim i pakënaqësisë së mosbesimit humbësor ndaj burimeve institucionale dhe raportimit medial, sidomos në aspektin e krizave politike dhe incidenteve të sigurisë.

Në favor të kësaj flasin edhe të dhënat që tregojnë se vetëm 20% e banorëve të veriut pranojnë ndikim të rëndësishëm të mediave tradicionale në qëndrimet e tyre, krahasuar me 24.6% në jug.




Edhe pse mediat tradicionale kanë humbur një pjesë të ndikimit të tyre, rrjetet sociale vazhdojnë të luajnë një rol të dukshëm në formësimin e opinionit publik, ndërsa familja dhe rrethi i ngushtë mbetin faktorë të qëndrueshëm në krijimin e qëndrimeve. Megjithatë, qëndrimet e udhëheqësve fetarë pothuajse nuk kanë asnjë ndikim në mendimin e qytetarëve, gjë që dëshmon më tej për sekularizimin e vendimmarrjes politike dhe racionalizimin e qëndrimeve, të paktën në kuptimin deklarativ. Kjo lëvizje drejt formimit individual të mendimit mund të ketë pasoja të rëndësishme për proceset e ardhshme të komunikimit publik: qytetarët po bëhen më kritikë ndaj informacionit që marrin, andaj për të ndikuar në mënyrë efektive në opinionin publik, nevojiten më shumë se thjesht narrativat mediatike — nevojiten pra argumentet bindëse, përvojat personale dhe rezultatet e dukshme të vendimeve politike.

	2024	2023	2022	2021	2020
Informacionet që merrni nga mediat	22.5%	26.6%	19.3%	20.6%	22.7%
Informacionet që merrni nga rrjetet sociale (p.sh. Facebook, grupe në Telegram etj.)	11.7%	-	-	-	-
Mendimet dhe qëndrimet e familjes, miqve dhe kolegëve tuaj	8.5%	4.6%	8.7%	12.4%	16.4%
Mendimet dhe qëndrimet e politikanëve	2.2%	4.9%	2.8%	2%	3.5%
Mendimet dhe qëndrimet e liderëve dhe institucioneve fetare	1.6%	2.5%	1.7%	2%	0.7%
Të gjitha ato që u përmendën	19.5%	29.6%	29.7%	29.1%	32.2%
E krijoj vetë mendimin tim	34%	31.9%	37.8%	33.9%	24.5%


A KENI MARRË PJESË NË REGJISTRIMIN E SIVJETSHËM NË KOSOVË?

Një tregues i mosbesimit është edhe qëndrimi ndaj regjistrimit të mbajtur këtë vit. Shumica ose nuk ka marrë pjesë (44,9%), ose nuk ka dashur të përgjigjet (11,9%), ndërsa pjesëmarrës kanë qenë 43,2%.



Siç pritej, shumica e atyre që kanë marrë pjesë jetojnë në jug të lbrit, megjithëse edhe atje ka një numër të konsiderueshëm (23%) që nuk kanë marrë pjesë.

■ Veriu i Kosovës
 ■ Komunitet me shumicë serbe në jug të lbrit




Sërish, sipas njërit nga bashkëbiseduesit tanë, „pjesëmarrja më e ulët në veri ka ardhur kryesisht si rezultat i revoltës së qytetarëve për shkak të situatës së përgjithshme politike dhe të sigurisë që i referohet para së gjithash veriut të Kosovës, pastaj për shkak të qëndrimit të paqartë të Beogradit zyrtar dhe thirrjeve për bojkot nga ana e disa përfaqësuesve politikë serbë“. Megjithatë, vazhdon bashkëbiseduesi, „arsyeja kryesore pse Beogradi nuk i ftoi serbët për regjistrim ishte pikërisht fakti që të mos zbulohet numri i saktë i serbëve, i cili vit pas viti zvogëlohet, pasi kjo do të përbënte në njëfarë mënyre një humbje për politikën e Beogradit dhe Listës Serbe gjatë 10 viteve të kaluara në Kosovë“.

Një bashkëbisedues tjetër, ndërkaq, thotë se „autoritetet jolegjitime në veri nuk kanë kapacitete për ta realizuar regjistrimin“. „Thirrja për bojkot me siguri ka ndikuar, po ashtu edhe te regjistruerit, sepse ishte mjaft jopopullore të bëheshe regjistruer nën presionin e komunitetit“. „Edhe sikur të mos kishte thirrje për bojkot“, vlerëson bashkëbiseduesi ynë, „do të kishte shumë probleme me cilësinë e të dhënave të mbledhura“. Në fund, „niveli deri në të cilin kanë depërtuar në të dhënat personale të qytetarëve, sidomos në historinë mjekësore të grave, ka qenë ndoshta i tepruar dhe i panevojshëm në disa kontekste“.

Megjithatë, pjesëmarrja e dobët në regjistrim do të ketë pasoja – „buxheti i ri tashmë është duke u përgatitur dhe vlerësimet janë se Agjencia e Statistikave do të përdorë të dhëna jo të plota për veriun, gjë që do të çojë në zvogëlimin e buxhetit për komunitet në veri. Në jug, Graçanica dhe Shtërpca, ku ka pasur pjesëmarrje më të lartë, mund të presin rritje të buxhetit“.


NGA CILI LLOJ MEDIASH INFORMOHENI MË SË SHPESHTI?

Qytetarët e kombësisë serbe që jetojnë në Kosovë më së shumti informohen nëpërmjet portaleve në internet, si dhe mediave tradicionale (televizionit dhe radioprogrameve). Në vendin e tretë janë rrjetet sociale.



Qytetarët që jetojnë në veri u besojnë pak më shumë informacioneve që marrin nëpërmjet rrjeteve sociale.

Veriu i Kosovës
Komunat me shumicë serbe në jug të Ibrit



Në pesë vitet e fundit, rëndësia e mediave tradicionale ka shënuar një rënie relative, ndërsa është rritur dukshëm numri i atyre që informohen përmes portaleve në internet.

	2024	2023	2022	2021
Mediave tradicionale (TV, radio)	32%	39%	34.6%	38.5%
Mediave të shtypura (gazeta)	2.6%	4.8%	3.8%	7.6%
Portaleve online të shtëpive mediatike	43.3%	31.2%	31.1%	30.6%
Rrjeteve sociale (Facebook, Twitter...)	21.7%	25%	30.4%	23.3%
Nuk është përgjigjur	0.4%	0%	0%	0%


CILËS MEDIA (APO MEDIEVE TË KUJT) I BESONI MË SHUMË?

Analiza e besimit në media tregon dallime të qarta në qëndrimet ndaj burimeve të ndryshme të informimit. Më së paku besim kanë mediat në gjuhën shqipe në Kosovë, me një vlerësim mesatar prej 1.73, që tregon mosbesim të theksuar ndaj atyre burimeve, ndoshta për shkak të dallimeve gjuhësore, kulturore dhe politike. Nga ana tjetër, besim më të madh gëzojnë mediat serbe në Kosovë, me një vlerësim mesatar prej 3.28, që sugjeron se qytetarët priren t’iu besojnë mediave që komunikojnë në gjuhën e tyre dhe që janë më afër përditshmërisë dhe përvojës së tyre jetësore. Besimi në mediat e pavarura nga Beogradi dhe mediat me frekuencë kombëtare nga Beogradi gjendet në mes të shkallës, me vlerësim mesatar prej 2.99 dhe 2.75. Ky rezultat tregon një besim të moderuar ndaj këtyre burimeve, por edhe një distancim të vetëdijshëm ndaj mediave jashtë Kosovës. Rënia e besimit në mediat nga Beogradi mund t’i atribuohet zhgënjimit të qytetarëve për shkak të perceptimit të raportimit të paplotë dhe politikisht të njëanshëm, që ka çuar në një perceptim negativ të këtyre mediave si burime të rëndësishme të informatave.

	Vlerësim mesatar
Mediave me frekuencë kombëtare nga Beogradi	2.75
Mediave të pavarura nga Beogradi	2.99
Mediave serbe në Kosovë	3.28
Mediave në gjuhën shqipe në Kosovë	1.73

Në përgjithësi, besimi në media është më i vogël në veri. Këtu të anketuarit u besojnë më pak mediave me frekuencë kombëtare nga Beogradi (nota mesatare 2,33) dhe akoma më pak mediave në gjuhën shqipe në Kosovë (1,54). Besimi ndaj mediave serbe në Kosovë është më i theksuar në komunitetet në jug të Ibrit, ku nota mesatare është 3,37.


- Veri i Kosovës
- Komunitat me shumicë serbe në jug të Ibrit




Trendët e pesë viteve të fundit tregojnë qartë një rritje të besimit në mediat nga Kosova, ndërsa besimi në mediat nga Beogradi është në rënie. Vlerësimi mesatar i besimit në mediat serbe në Kosovë është rritur nga 2.79 në 3.28, që tregon një rritje të konsiderueshme të besimit në burimet lokale të informacionit. Ky trend ndërlidhet me një ndjenjë më të fortë identiteti dhe me njohjen e gazetarisë së përgjegjshme në Kosovë, e cila veçanërisht ka dalë në pah në situatat e krizës në veri të Kosovës, ku shpejtësia dhe besueshmëria e informacionit të ofruar ishin kyçe dhe janë vlerësuar më së shumti.

	2024	2023	2022	2021	2020
Mediave me frekuencë kombëtare nga Beogradi	2.75	2.69	3.35	3.29	2.85
Mediave të pavarura nga Beogradi	2.99	2.88	2.97	3.12	2.69
Mediave serbe në Kosovë	3.28	2.94	2.92	2.82	2.79
Mediave në gjuhën shqipe në Kosovë	1.73	1.72	1.60	1.57	1.61


A MENDONI SE MUND T'I SHPREHNI LIRSHËM QËNDRIMET TUAJA?



Rezultatet inkurajuese lidhur me lirinë e shprehjes së mendimeve në mesin e pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë tregojnë se një numër i madh i të anketuarve ende besojnë se mund ta shprehin lirshëm mendimin e tyre, gjë që tregon për një kornizë relativisht pozitive për diskutim publik dhe angazhim politik. Më konkretisht, 43.7% e të anketuarve janë përgjigjur se mund të shprehin lirshëm qëndrimet e tyre, ndërsa 12.5% besojnë se këtë mund ta bëjnë në mënyrë të plotë dhe të pakufizuar. Këta faktorë bëhen veçanërisht të dukshëm në lidhje me proceset shoqërore-politike që kanë karakterizuar vitet e fundit dhe që kanë ndikuar në trendet brenda komunitetit serb në Kosovë.




A JANË QËNDRIMET E PAVARURA DHE MENDIMI KRITIK TË PËRFAQËSUARA MJAFTUESHËM NË MEDIAT E KOSOVËS?



Kontinuiteti i rritjes së besimit në mediat lokale, megjithëse i rëndësishëm, ende nuk ka arritur të kapërcejë dyshimet e thella të rrënjësura lidhur me pavarësinë e tyre dhe praninë e mendimit kritik, gjë që tregon për ekzistencën e një skepticizmi të theksuar ndaj rolit të mediave si hapësirë për shkëmbim të lirë të qëndrimeve. Ndërsa besimi në media po zhvillohet gradualisht, është thelbësore të identifikohen faktorët specifikë që ende formësojnë perceptimin publik, veçanërisht në mesin e komuniteteve që jetojnë në jug të Ibrit. Kjo dukuri mund të shihet si pasqyrë e një kornize të ndërlikuar shoqërore-politike brenda së cilës funksionojnë mediat, ku redaksitë në gjuhën serbe përballen me burime të kufizuara financiare dhe sfida lidhur me lirinë e raportimit. Përveç dobësive strukturore, shqetësim të veçantë shkaktojnë edhe forma të ndryshme të presioneve indirekte, të cilat shpesh e dobësojnë kapacitetin për gazetari të pavarur dhe të përgjegjshme.


Për më tepër, fakti që prej vitesh mungon shkëmbimi politik i mendimeve dhe dialogu konstruktiv midis përfaqësuesve politikë të serbëve në Kosovë tregon më tej për mungesën e hapësirës për debat të hapur dhe pluralist. Në një kontekst të tillë, është jashtëzakonisht i vështirësuar formimi i një sfere publike që do të krijonte terren të përshtatshëm për analiza objektive dhe kritike, veçanërisht kur bëhet fjalë për tema të ndjeshme si marrëdhëniet ndëretnike, konfliktet historike, proceset post-konfliktuale dhe narrativat politike që në mënyrë të theksuar kontribuojnë në polarizimin e marrëdhënieve shoqërore. Duke marrë parasysh këto sfida, është e domosdoshme të mendohet për strategjitë që mund të kontribuojnë në forcimin e pavarësisë së mediave, hapjen e hapësirës për shkëmbim të lirë të mendimeve dhe nxitjen e debatit publik kritik si parakushte për marrëdhënie më të qëndrueshme shoqërore në Kosovë.






**SIGURIA E
QYTETARËVE**

A ËSHTË RREZIKUAR SIGURIA JUAJ OSE E FAMILJES SUAJ TË NGUSHTË GJATË VITIT TË KALUAR?



Të dhënat tregojnë se ndjenja e sigurisë personale tek pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë vazhdon të jetë seriozisht e dëmtuar. Mesatarisht, çdo person i pest i anketuar (18,1%) konsideron se siguria e tij ka qenë e cenuar gjatë vitit të kaluar, gjë që tregon për ekzistencën e një ndjenje të përhershme pasigurie brenda komunitetit. Kjo ndjenjë është edhe më e theksuar në veri të lumit Ibër, ku madje 29,1% e të anketuarve deklarojnë se janë ndjerë të cenuar, që është pothuajse dyfish më shumë se mesatarja. Këto gjetje tregojnë se, ndonëse në nivel deklarativ ekziston një perceptim i caktuar për mundësinë e shprehjes së lirë, ndjenja e pasigurisë në jetën e përditshme mbetet një problem serioz, veçanërisht në zonat ku tensionet politike dhe të sigurisë kanë qenë më të theksuara. Veriu i Kosovës, si një hapësirë me sfida specifike të sigurisë, konfirmon se stabiliteti vazhdon të jetë i brishtë dhe se çdo përshkallëzim mund të çënojë ndjeshëm balancën tashmë të ndjeshme.




Edhe pse numri i të anketuarve që kanë raportuar ndjenjën e rrezikut është dukshëm më i ulët krahasuar me vitin e kaluar — nga 61% në vitin 2023 në 18.1% në vitin 2024 — ende bëhet fjalë për një përqindje të konsiderueshme që tregon qartë për ekzistencën e një ndjenje të vazhdueshme të pasigurisë. Kjo rënie, ndonëse inkurajuese, nuk e eliminon frikën e thellë të rrënjosur lidhur me paqëndrueshmërinë politike dhe potencialin për dhunë. Frika, veçanërisht e theksuar në veri të Kosovës, mbetet një kornizë e rëndësishme për të kuptuar qëndrimin e qytetarëve ndaj proceseve politike, institucioneve dhe jetës së përditshme. Niveli i lartë i perceptimit të cënueshmërisë, edhe përkundër përmirësimit të dukshëm krahasuar me vitin paraprak, tregon se siguria ende nuk përjetohet si një kategori e qëndrueshme dhe e garantuar, por si një gjendje e brishtë që mund të ndryshojë shpejt në rast të krizave të reja.


	2024	2023	2022	2021	2020
Po, ka qenë e rrezikua	18.1%	61.4%	16.4%	18.3%	18.5%
Jo, nuk ka qenë	81.3%	38.6%	83.6%	81.7%	81.5%
Pa përgjigje	0.6%	0%	0%	0%	0%

CILAT JANË RREZIQET MË TË MËDHA TË SIGURISË NË MJEDISIN TUAJ?

Qytetarët e identifikojnë shumë mirë se çfarë përbën rrezikun më të madh në mjedisin e tyre: para së gjithash, „paqëndrueshmëria politike“, pastaj „incidentet ndëretnike“ dhe „krimi“.




Të dhënat janë pothuajse të njëjta si për të anketuarit në veri, ashtu edhe për ata në jug, me dallime të vogla të vërejtura.






**TENDENȚAT E
MIGRIMIT**

A ËSHTË LARGUAR DIKUSH NGA RRETHI JUAJ NGA KOSOVA VITIN E FUNDIT?



Të dhënat tregojnë se dukuria e largimit vazhdon të jetë jashtëzakonisht e theksuar në mesin e komunitetit serb në Kosovë. Madje dy të tretat e të anketuarve (66%) deklarojnë se dikush nga rrethi i tyre i ngushtë e ka lënë Kosovën gjatë vitit të kaluar. Ky trend është më i shprehur në veri, ku 70.9% e të anketuarve njohin dikë që është larguar, ndërsa në jug kjo përqindje është pak më e ulët, por ende e lartë — 61.3%. Migrimi i pjesëtarëve të komunitetit serb pasqyron një humbje të thellë të besimit në mundësinë e stabilitetit afatgjatë, incidente të shpeshta të sigurisë, si dhe presionet ekonomike dhe shoqërore që e nxisin më tej largimin. Ajo që shqetëson veçanërisht është fakti se pjesa më e madhe e atyre që kërkojnë daljen nga pasiguria shumëvjeçare janë të rinjtë — madje dy të tretat e tyre — gjë që dobëson më tej potencialin demografik dhe zhvillimor të komunitetit serb në vitet që vijnë.




Numri i atyre që kanë lënë Kosovën arriti kulmin në vitin 2023, kur madje 83.8% i të anketuarve nga komuniteti serb deklaruan se njohin dikë që është larguar nga vendi. Edhe pse në vitin 2024 kjo përqindje ka rënë disi, largimi mbetet një trend i theksuar dhe shqetësues.

Ky proces pasqyron drejtpërdrejt presionet e vazhdueshme që komuniteti serb ka përjetuar gjatë tre viteve të fundit, para së gjithash për shkak të incidenteve të shpeshta të sigurisë, tensioneve politike dhe mbylljes së institucioneve të financuara nga Republika e Serbisë, të cilat ofronin shërbime thelbësore për qytetarët. Këto masa, të cilat lidhen me vendimet e Qeverisë së Kosovës, kanë destabilizuar më tej jetën e përditshme të serbëve në Kosovë, kanë ulur ndjesinë e sigurisë personale dhe kanë kontribuar në perceptimin e përgjithshëm të të anketuarve se mundësitë për të qëndruar dhe për të pasur një jetë të dinjitetshme janë dëmtuar në mënyrë serioze.


	2024	2023	2022	2021	2020
Po	66%	83.8%	78.7%	69.8%	77.2%
Jo	34%	16.2%	21.3%	30.2%	22.8%

DUKE PASUR PARASYSH NJERËZIT QË NJIHNI DHE QË E KANË BRAKTISUR KOSOVËN, A KA MES TYRE FËMIJË QË E KANË LËNË SHKOLLËN FILLORE?




Në mesin e atyre që kanë lënë Kosovën, në madje 77.1% të rasteve, të anketuarit identifikojnë fëmijë të moshës të shkollës fillore. Ky tregues nënvizon një problem serioz që lidhet drejtpërdrejt me çështjen e sigurisë dhe perceptimin e mungesës së saj, ku pikërisht kjo është njohur si arsyeja kryesore për largimin e familjeve me fëmijë në shkollë, kryesisht drejt Serbisë qendrore. Trendi i largimit të nxënësve të shkollave fillore është veçanërisht i theksuar në mjediset në veri të Ibrit, ku 70.9% e të anketuarve thonë se njohin dikë që ka lënë Kosovën. Në jug, kjo përqindje është pak më e ulët, por ende shqetësuese – 61.3%. Këto të dhënat tregojnë për një destabilizim serioz të komunitetit, pasi largimi i fëmijëve të moshës shkollore dobëson në menyrë afatgjate kapacitetet e komunitetit serb për të ruajtur infrastrukturën e tij shoqërore dhe kulturore në Kosovë.

A E SHIHNI VETEN NË KOSOVË GJATË PESË VITEVE TË ARDHSHME?



Lëvizjet e trendeve në mesin e komunitetit serb në Kosovë shihen qartë në përgjigjet në pyetjen “A e shihni veten në Kosovë në pesë vite të ardhshme?”. Gati një e treta e të anketuarve (31.8%) deklarojnë se “do të largoheshin nëse u jepet mundësia”, ndërsa 20.3% të tjerë thonë drejtpërdrejt se nuk e shohin veten fare në Kosovë. Prandaj, shumica dërrmuese shpreh synimin apo gadishmërinë për t’u larguar. Situata është edhe më e pafavorshme në veri të Kosovës, ku madje 58.3% e të anketuarve shfaqin tendencë largimi, ndërsa në komunat në jug të Ibrit kjo përqindje është disi më e ulët, por ende shqetësuese – 46.1%. Këto të dhëna alarmante dhe të përsëritura tregojnë për një ndjenjë thellësisht të rrënjosur të pasigurisë dhe të pesimizmit në lidhje me qëndrueshmërinë afatgjatë të jetës së komunitetit serb në Kosovë.




Gjatë pesë viteve të fundit vërehet një ndjenjë e theksuar dhe e vazhdueshme pesimizmi brenda komunitetit serb në Kosovë, e cila reflektohet edhe në perceptimin për të ardhmen personale. Trendi negativ mbetet i pranishëm – çdo i dyti i anketuar deklaron se e sheh veten në Kosovë gjatë pesë viteve të ardhshme. Ky rezultat tregon për një mosbesim të thellë të rrënjosur në mundësinë për një jetë të qëndrueshme dhe dinjitoze në rrethanat aktuale shoqërore-politike.


	2024	2023	2022	2021	2020
Po	47.3%	44.5%	51.7%	44.7%	53.9%
Jo	20.3%	31.8%	21%	29.1%	20.4%
Do të largohem nëse më jepet mundësia	31.8%	23.7%	27.3%	26.2%	25.7%
Nuk është përgjigjur	0.6%	0%	0%	0%	0%

Cila është arsyeja kryesore pse do të largoheshit nga Kosova?

Arsyet kryesore që të anketuarit i përmendin për largimin e mundshëm janë mbi të gjitha pasiguria politike dhe mosrespektimi i të drejtave të serbëve në Kosovë. Këto tema dominojnë si faktorët më të rëndësishëm që formësojnë perceptimin për të ardhmen në Kosovë. Menjëherë pas tyre vijnë siguria personale dhe pasiguria ekonomike, të cilat e thellojnë edhe më tej ndjenjën e pasigurisë dhe nxisin mendimin për largim. Kjo strukturë e përgjigjeve tregon se prirjet migratore nuk janë të motivuara vetëm nga faktorët ekonomikë, por në masë të madhe edhe nga perceptimi i një mjedisi politik dhe shoqëror që shihet si i paqëndrueshëm dhe i pafavorshëm për qëndrim afatgjatë.




Përgjigjet shfaqen me frekuencë të ngjashme si në veri ashtu edhe në jug, me përjashtim të „mosrespektimit të të drejtave“, që është më i theksuar në përgjigjet e qytetarëve që jetojnë në veri (28% krahasuar me 22% në jug).






**QËNDRIMET
NDAJ BASHKIMIT
EVROPIAN**

KUR DËGJONI “BASHKIMI EVROPIAN”, ASOCIACIONI JUAJ I PARË ËSHTË POZITIV APO NEGATIV?



Ndërmjetësuesit në dialog duhet të shqetësohen për perceptimin kryesisht negativ të rolit të Bashkimit Evropian. Ky perceptim është vetëm pak më i mirë sesa në vitin 2023, kur ishte 13%. Kjo perceptim negativ është, ndoshta edhe në mënyrë të pritshme, më i theksuar në veri të Ibrit.




Kjo përqindje ka ndryshuar vetëm pak gjatë pesë viteve të fundit, ndërkohë që një numër i madh i të anketuarve ende „nuk kanë qëndrim“ ndaj rolit të BE-së, gjë që është mjaft e vështirë të shpjegohet duke pasur parasysh rolin e saj qendror në procesin e dialogut.


	2024	2023	2022	2021	2020
Pozitiv	16.9%	13%	9.8%	12.4%	12%
Negativ	46.5%	51.5%	52.8%	48%	48.5%
Nuk kam qëndrim	36.6%	35.5%	37.4%	39.6%	39.4%

SI E SHIHNI POZICIONIN E BASHKIMIT EVROPIAN NË PROCESIN E NEGOCIATAVE NDËRMJET BEOGRADIT DHE PRISHTINËS?

Në përgjithësi, qytetarët mendojnë se Brukseli favorizon Prishtinën.



Ka një diferencë në përgjigjet e të anketuarve nga veriu i Kosovës dhe ata që jetojnë në jug të Ibrit. Kështu, qytetarët në komunat në jug besojnë më shumë se BE-ja vepron në mënyrë neutrale në përpjekjet e saj.





Të dhënat empirike tregojnë për një forcim të ngadalshëm të perceptimit të neutralitetit të Bashkimit Evropian në procesin negociues ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit gjatë pesë viteve të fundit. Megjithatë, përkundër këtij trendi, afërsisht dy të tretat e të anketuarve ende mendojnë se BE-ja e favorizon Prishtinën, një qëndrim që përsëritet në mënyrë të vazhdueshme në analizat e opinionit publik gjatë të njëjtës periudhë.

	2024	2023	2022	2021	2020
BE-ja është neutrale	24.9%	19.4%	23.5%	23.3%	16.8%
BE-ja është më shumë në anën e Prishtinës	73.2%	78%	75.6%	74.1%	80.8%
BE-ja është më shumë në anën e Beogradit	1.6%	2.6%	0.9%	2.6%	2.4%
Nuk është përgjigjur	0.3%	0%	0%	0%	0%

Edhe pse serbët në Kosovë nuk kanë një qëndrim veçanërisht pozitiv ndaj Bashkimit Evropian dhe nuk i besojnë plotësisht, ata njëkohësisht e njohin domosdoshmërinë e saj. Kjo ambivalencë pasqyrohet edhe në nivelin e lartë të pajtueshmërisë me qëndrimet se “BE-ja ka një rol kyç në pajtimin ndëretnik në Kosovë” (vlerësim mesatar 2.52), si dhe se “ka një rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb” (vlerësim mesatar 2.77).

	Vlerësim mesatar
BE-ja ka një rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë	2.77
BE-ja luan një rol kyç në pajtimin ndëretnik në Kosovë	2.52
BE-ja investon mjaftueshëm në mjediset me shumicë serbe në Kosovë	1.96

Përsëri, në përputhje me përgjigjet e tjera, të gjitha vlerat e përmendura janë më të ulëta në veri të Ibrit.



Vetëdija se Bashkimi Evropian ka një rol kyç si në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb, ashtu edhe në procesin e pajtimit ndëretnik, është forcuar gradualisht gjatë pesë viteve të fundit, pavarësisht rënies në vitin 2023. Megjithatë, shqetësues mbetet fakti se përpjekjet e BE-së të drejtuara ndaj investimeve në mjediset serbe vazhdojnë të vlerësohen dobët, me një vlerësim mesatar që nuk arrin as pragun bazë të nivelit të kënaqshëm të besimit.


	2024	2023	2022	2021	2020
BE-ja ka një rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë	2.77	2.76	3.35	2.60	2.42
BE-ja luan një rol kyç në pajtimin ndëretnik në Kosovë	2.52	2.49	2.38	2.44	2.24
BE-ja investon mjaftueshëm në mjediset me shumicë serbe në Kosovë	1.96	2.00	1.89	2.20	2.00




**DISTANCA
ETNIKE**

Për të avancuar në aspektin e pajtimit, duhet të tejkalojmë ekzistencën e distancës etnike. Dhe kjo do të jetë e vështirë të tejkalohet nëse qytetarët „rrallë“ ose „asnjëherë“ interaktojnë me qytetarët e kombësisë shqiptare, dhe pse ndodh kështu, është një temë e një hulumtimi tjetër.

SA SHPESH SHKONI NË ZONAT KU SHQIPTARËT JANË SHUMICË?




Natyrisht, gjërat janë ndryshe në jug – atje qytetarët e kombësisë serbe lëvizin çdo ditë, ose shpesh, në mjedise ku shqiptarët janë shumicë.



Është e rëndësishme të theksohet se numri i pjesëtarëve të komunitetit serb të cilët realizojnë kontakte të përditshme ose të shpeshta (një herë ose më shumë në javë) me shqiptarët ka shënuar një rritje krahasuar me vitin 2023, gjë që përbën një trend pozitiv, ndërkohë që njëkohësisht ka rënë përqindja e atyre që kanë kontakte të rralla me pjesëtarët e komunitetit shqiptar.


	2024	2023	2022	2021	2020
Asnjëherë	12.7%	13.7%	10.1%	9.6%	14.8%
Rrallë (më pak se një herë në javë)	33.6%	44.8%	38.8%	50.4%	48.5%
Shpesh (një herë deri në disa herë në javë)	31.2%	25.2%	40.6%	31.5%	30.4%
Çdo ditë	22.5%	16.3%	10.5%	8.5%	6.3%

Përvojat tuaja nga kontaktet personale me shqiptarët janë kryesisht:



Eksperiencat e interaksioneve janë kryesisht pozitive (31.4%) ose neutrale (50.9%), nga e cila mund të nxirret përfundimi se kundërshtimi ndaj vetë interaksionit është i paarsyeshëm (dhe se presioni ushtrohet nga dikush tjetër, shumë larg „njeriut të zakonshëm“).

Frekuenca e eksperiencave negative dhe pozitive është pak më e theksuar në përgjigjet e të anketuarve që jetojnë në veri të Ibrit.



Pas kulminacionit të regjistruar në vitin 2023, frekuenca e përvojave negative u ul sërish dhe u stabilizua në 12.3%. Numri i qytetarëve që thanë se “nuk kanë kontakt me shqiptarët” ka rënë nga 15% në 5%.

	2024	2023	2022	2021	2020
Pozitive	31.4%	20.1%	21.5%	18.5%	21%
Negative	12.3%	24.5%	12%	13.3%	8.7%
Neutrale	50.9%	48.4%	52.8%	56.7%	55.2%
Nuk kam asnjë kontakt me shqiptarët	5.2%	7%	13.7%	11.5%	15%
Nuk është përgjigjur	0.2%	0%	0%	0%	0%

Distanca është më e madhe mes serbëve dhe shqiptarëve, ndërsa marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe përfaqësuesve të komuniteteve të tjera (boshnjakëve, romëve, etj.) janë të mira ose shumë të mira (me vlerësim mesatar më të madh se 3,5).

	AS
Serbëve dhe shqiptarëve	2.31
Serbëve dhe boshnjakëve	3.32
Serbëve dhe goranëve	3.71
Serbëve dhe romëve	3.47

Edhe pse vazhdojnë të përsëriten vlerësimet e përcaktuara më herët të kundërshtimit pothuajse absolut ndaj mundësisë që një shqiptar/e të jetë dhëndër/nuse apo partner martesor, inkurajon fakti se është në rritje numri i atyre që nuk kanë më problem të pranojnë një shqiptar/e si koleg/e pune, epror/e, apo, gjë që është veçanërisht e rëndësishme, si mik/mike.





PĚRFUNDIM

Qytetarët e nacionalitetit serb që jetojnë në Kosovë luftojnë dhe mbijetojnë brenda një sistemi i cili për vite me radhë i ka "përrjashtuar" dhe neglizhuar, ndërsa vështrimin e mbajnë drejt një sistemi tjetër që, përveç mbështetjes materiale (e cila nuk është e vogël), nuk mund t'u ofrojë shumë më tepër. Por, kjo rezistencë nuk është e përhershme. Ajo varet nga ekzistenca e perspektivës ekonomike dhe asaj në sfera të tjera, presioneve migratore, jostabilitetit politik dhe në fund – çështjes së sigurisë fizike.

Megjithatë, edhe përkundër gjithçkaje, të anketuarit tregojnë një qëndrueshmëri të jashtëzakonshme. Në pyetjen mbi statusin material, një numër i konsiderueshëm i tyre (praktikisht 4 nga 10 të anketuar – 38,9% në veri dhe 41% në jug të Ibrit) përgjigjen me "neutral", pra me notën 3.

Sipas fjalëve të njërit prej bashkëbiseduesve tanë, "ka kuptim që qytetarët në veri të jenë më të pakënaqur me cilësinë e jetës në krahasim me ata në jug," sepse "masat e qeverisë në Prishtinë janë të orientuara kryesisht drejt veriut." Kujtojmë se atje mbyllen organet e përkohshme që funksionojnë sipas sistemit serb, ndërsa në jug të Ibrit, ato nuk janë mbyllur plotësisht.

Distanca e lartë etnike mes serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë vazhdon të jetë prezente. Marrëdhëniet individuale tregojnë se përkatësia etnike ndikon më së shumti negativisht kur bëhet fjalë për zgjedhjen e partnerit në martesë apo lidhjeve të tjera familjare. Megjithatë, pak më shumë se gjysma e të anketuarve do ta pranonin një shqiptar si mik, gjë që tregon se kjo është një fushë ku në perspektivë distanca etnike mund të zvogëlohet.

Së fundmi, të gjithë akterët e përfshirë në proceset politike në Kosovë do të duhej të shqetësohen mbi të dhënat që paraqesim në këtë hulumtim. Ato tregojnë se shoqëria kosovare po ecën prapa; se është humbur, dhe mbetet të shihet nëse në mënyrë të pakthyeshme, shumë nga ato gjëra pozitive që dialogu dhe normalizimi i kanë sjellë; si dhe se, në kontekstin e zgjidhjeve të imponuara dhe politikës së faktit të kryer, pakënaqësia e komunitetit vetëm sa do të rritet.

